

... të fëmijëve në transmetime
... esën e Autoritetit të Med
... ive që prej muajit prill ka
... tur më **Buletini i** shumë
... mendime **Lëshillit të** për
... cilave kanë **Ankesave.** "N
... të drejtë të kërkojë, të het
... të marrë dhe të ndajë info
... dhe ide, pa asnjë lloj censu
... dios, tu dhe mjeteve të tjer
... ikimit audioviziv apo ndor
... tjetër bazuar në përzgjed
... m nëse këtë e bën në kuad
... timit të sundin
... tave të njeriut.
... me krijimin e shërbimeve



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

NR. 11

Dërbajtja

Hyrja	04
Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave	06
SEKSIONI I	
Ankesa me objekt "Cënimin e rregullave të etikës dhe dinjitetit".....	09
SEKSIONI II	
Ankesa me objekt "Cënimin e të drejtave të fëmijëve".....	14
SEKSIONI III	
Ankesa me objekt "Komunikime tregtare të ndaluara".....	21
SEKSIONI IV	
Ankesa me objekt të ndryshëm	24
SEKSIONI V	
Ankesa të rrëzuara	27

Dy fjalë

në vend të hyrjes

Individë, organizata por edhe institucione i kanë referuar Këshillit të Ankesave shkeljet e parimeve, normave dhe rregullave të ligjit të mediave audiovizive dhe Kodit të Transmetimit, të përmbajtjeve të ndryshme audiovizive. Numri më i lartë i ankesave lidhet kryesisht me përmbajtje që cenojnë të drejtat e fëmijëve, që cenojnë imazhin, me reklamën e fshehur dhe të tjera me objekt të ndryshëm.

Në raportimin e ngjarjeve që lidhen me fëmijët, Operatorët e Shërbimit Mediatik Audioviziv kryejnë shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive", i ndryshuar si dhe të Kodit të Transmetimit. Këto shkelje ndodhin qoftë gjatë raportimit të lajmeve në programet informative dhe formate të tjera, qofshin këto investigative apo kulturore dhe argëtuese.

Kjo megjithëse, prania e fëmijëve në transmetimet audiovizive rregullohet si nga ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive", i ndryshuar (nenet 4, 33 dhe 46) ashtu edhe nga Kodi i Transmetimit, seksioni 5 "Fëmijët në transmetimet audiovizive".

Këshillit të Ankesave i janë drejtuar edhe ankesa të tjera, si p.sh. për cenim dinjiteti, ankesa me objekt të ndryshëm si dhe reklamë të fshehur. Kuadri rregullator edhe për trajtimin e këtyre ankesave ka gjithashtu mbështetje të dyfishtë, si në ligjin "Për mediat audiovizive" ashtu edhe Kodin e Transmetimit.

Këshilli i Ankesave, pjesë e Autoritetit të Mediave Audiovizive vijon të trajtojë me përparësi çdo ankesë të ardhur. Trajtimi i ankesave bazuar në legjislacionin për mediat audiovizive dhe Kodin e Transmetimit mbetet prioritet i punës së kësaj strukture zgjidhja e plotë e ankesave. Është fakt që rritja e ankesave drejtuar Këshillit të Ankesave, pranë AMA-s, vjen edhe si shkak i rritjes së besimit ndaj institucionit dhe ndërgjegjësimit të opinionit publik.

Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave

Mbështetur mbi Ligjin nr. 97/ 2013 për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë dhe Kodit të Transmetimit, shikuesit dhe dëgjuesit e subjekteve audiovizive kanë të drejtën të ankohen rreth përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, nëse ata besojnë dhe mendojnë që subjektet kanë cenuar apo shkelur parimet dhe rregullat etike, të hartuara në Ligjin Nr. 97/2013 dhe ato në Kodin e Transmetimit.

Por që të mund të ngrihet një ankesë duhet të identifikohet më parë programi apo emisioni, të cilit ankesa i referohet, duke përfshirë datën dhe kohën e transmetimit. Gjithashtu, ankuesi duhet të shpjegojë se çfarë cenimi/shkelje ka vërejtur në përmbajtjen e programit që e ka detyruar atë të ngrejë një ankesë.

Është shumë e rëndësishme të përcaktohen qartësisht argumentet e një ankesë dhe përse materiali programor apo përmbajtja komerciale nuk pajtohet me parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikën e përcaktuara në Ligjin nr. 97/2013 dhe në Kodin e Transmetimit. Ligji për mediat audiovizive dhe Kodi i Transmetimit mund të gjenden në faqen zyrtare të AMA-s: www.ama.gov.al.

Në një nga seksionet e kësaj faqeje, pasi të klikoni në rubrikën "**Formular ankesë për shkeljen e Kodit të Transmetimit**", plotësoni formularin me të dhënat që kërkohen ose mund të shkruani në adresën zyrtare të AMA-s: info@ama.gov.al. Në përputhje me procesin e ankimit, shikuesi apo dëgjuesi duhet të dërgojë ankesën në adresën që gjendet në fund të fletës së ankesës, pasi ka lexuar me kujdes udhëzimet për hartimin e saj, por mbi të gjitha parimet dhe rregullat e Kodit të Transmetimit.

Në disa raste, publiku vetë mund t'ua drejtojë OSHMA-ve ankesat që ai harton, kur e mendon se kjo është një rrugë më e shpejtë dhe që subjekti mund të reflektojë. Kur shikuesi apo dëgjuesi nuk mbetet i kënaqur me përgjigjen nga transmetuesit ose, nëse transmetuesi nuk përgjigjet, atëherë ai mund ta referojë ankesën e tij në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në faqen e tij zyrtare ose me postë.

Sa i përket trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave në shqyrtimin e çdo ankesë që i mbërrin, bazohet mbi kodet dhe rregullat përkatëse në ligj, në materialin e shkruar të paraqitur nga palët përkatëse, si dhe materialin e transmetimit. Ankesat shqyrtohen në nivel ekzekutiv nga Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me drejtorinë e tjera të AMA-s, si Drejtoria e Programeve, Drejtoria Juridike dhe ajo e Mbikëqyrjes.

Detajet e shqyrtimit dhe vendimet mbi ankesat për përmbajtjen e transmetimeve audiovizive të marra nga Këshilli i Ankesave janë publikuar në këtë dokument, i cili quhet **Buletini i Këshillit të Ankesave**. Vendimet merren mbi çështjen, nëse një program apo një komunikim tregtar ka apo nuk ka respektuar kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullat e Kodit të Transmetimit. Vendimet nuk lidhen me miratimin apo përkrahjen që mund t'u bëhet palëve në ankesë dhe gjithashtu ato nuk vijnë si rezultat i trajtimit të çdo aspekti të detajuar që përmban vetë ankesa. Këshilli i Ankesave nuk kryen asnjë vlerësim të veçantë apo të pavarur jashtë çështjeve të parashtruara në ankesë.



Ankesa me
objekt
"Cënimin e
rregullave
të etikës
dhe dinjitetit"

Ankesa e paraqitur nga: **Disa ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
RTV "Ora News"	Emisioni "Expuls"	19.10.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Dhjetëra ankesa iu drejtuan Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive për emisionin "Expuls", të transmetuar në televizionin "Ora News", në 17.10.2021. Ankuesit pretendonin se "është diskriminuar komuniteti mysliman duke u vënë në lojë feja".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesave, Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin përkatës filmik dhe konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit.

Gjatë emisionit, ku ishte trajtuar tema e operacioneve plastike, moderatori dhe të ftuarit u ishin qasur deklarimeve të një hoxhe (transmetuar për disa minuta përmes një videoje), në një mënyrë të papërshtatshme, fyese, tallëse dhe denigruese.

Duke respektuar rolin e medias në trajtimin e temave të ndjeshme, përfshirë edhe ato me karakter fetar, qoftë drejtpërdrejt në studio, qoftë edhe përmes lidhjeve të ndryshme jashtë studios, Këshilli i Ankesave i rikujtoi OSHMA-së zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të Kodit të Transmetimit.

Referuar ligjit, në transmetimet e tyre mediat audiovizive duhet "të mos cenojnë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut" (neni 33, pika 1, germa ç) dhe "nuk duhet të transmetojë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi" (neni 32, pika 4).

Gjithashtu, edhe Kodi i Transmetimit, si akti nënligjor më i rëndësishëm për mediat audiovizive, që rrjedh nga ligji i sipërcituar, ndalon transmetimet që nxisin diskriminimin, në pikën 1.5 të tij, ku sanksionohet se "Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve" dhe në pikën 4.8, ku përcaktohet se "Transmetimet audiovizive informative nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptojnë mesazhe diskriminuese për shkaqe si: gjinia, raca, mosha, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore ose çdo shkak tjetër".

Bazuar në sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive:

- I tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit;
- I kërkoi ndalimin e ritransmetimit të emisionit "Expuls" të datës 17.10.2021, si dhe editimin/korrektimin e materialit filmik në kanal zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga: **T.A**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
News 24	Emisioni "Me zemër të hapur"	04.11.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Shtetasja T.A. i drejtoi një ankesë, Këshillit të Ankesave në lidhje me emisionin "Me zemër të hapur", të transmetuar në televizionin "News 24", në datën 23.09.2021. Ankuesja pretendonte se gjatë emisionit i ishte cenuar privatësia, ishin publikuar të dhënat e saj personale si dhe ishin ngritur disa akuza ndaj saj. Në ankesën e saj, thuhej se "megjithëse kishte refuzuar ftesën për të qenë pjesë e emisionit, në emision ishte prezantuar ish -bashkëshorti i saj, duke e identifikuar tërthorazi si dhe ishte këmbëngulur që znj. T.A të ishte në emision". Gjithashtu, "gjatë emisionit", - deklaroi ankuesja, - "ishte transmetuar me titra "shkelëse e besnikërisë bashkëshortor" etj. Në ankesën e saj, ajo shtonte gjithashtu se "megjithëse i kishte komunikuar stafit të medias audiovizive t'i respektohej e drejta për privatësi, drejtuesja e emisionit dhe stafi nuk e kishin bërë".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s i mori në shqyrtim pamjet filmike të emisionit "Me zemër të hapur" dhe konstatoi shkelje të dyfishtë të ligjit të medias dhe Kodit të Transmetimit.

Gjatë këqyrjes se materialit filmik u evidentua se ankuesja ishte identifikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përmendjen e emrit të saj por edhe në mënyrë të tërthortë me praninë dhe prezantimin e ish - bashkëshortit në studio e emisionit. Në kundërshtim me vullnetin e ankueses, ky identifikim i dyfishtë përbën shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit.

"Operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen edhe nga këto parime: ç)respektimi dhe garantimi i së dre-

jtës së ruajtjes së jetës private", (Neni 4, pika 2, germa ç). Gjithashtu, Kodi i Transmetimit ka një seksion të veçantë për respektimin e jetës private të individëve në transmetimet audiovizive (pika 3.1) ku sanksionon se:

"Shpërndarja e informacionit tek publiku, duke përfshirë këtu edhe fotografitë për jetën private të individëve pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interesi i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut, duke e tejkaluar të drejtën e privatësisë. Gazetari duhet të sigurohet, për të zbatuar standardet më të larta profesionale që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale. Përfshirja në jetën publike nuk i përjashton individët nga e drejta për privatësi, përveç rasteve kur rrethanë e këtyre mund të ndikojnë në performancën e tyre ose në përshtatjen me rolet publike që mbajnë ose kërkojnë".

Këshilli i Ankesave çmoi se çështja e trajtuar në emisionin "Me zemër të hapur" nuk përligjete në asnjë moment shkeljen e privatësisë së znj. T.A, pasi ajo nuk përbënte interes publik, referuar përcaktimeve të ligjit të medias dhe të Kodit të Transmetimit.

Nisur nga konstatimet e mësipërme si dhe titrimet gjatë emisionit për çështjen e trajtuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive i tërhoqi vëmendjen dhe kërkoi ndalimin e çdo praktike, që shkel privatësinë dhe të dhënat personale në përmbajtjet audiovizive që transmetohen.

Në vendimin final, Këshilli i Ankesave i kërkoi OSHMA-së heqjen e materialit përkatës filmik nga kanali zyrtar në Youtube, si dhe i rikujtoi që shkelje të ngjashme do shoqërohen me sanksionet e parashikuara ligjore.

Ankesa e paraqitur nga:

Prokuroria pranë Gjykatës, Shkalla e Parë Gjirokastrë

Subjekti audioviziv

Programi

Data

TV "Klan"**Emisioni "Stop"****19.11.2021****1. Përmbledhje e Ankesës**

Drejtuksi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, z. J. Ç. i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave në lidhje me emisionin investigativ "Stop", transmetuar në televizionin "Klan", më datë 09.09.2021. Sipas ankuesit "janë disa raste të përsëritura, që në çështjet penale, në të cilat avokati A.Ll. përfaqëson persona të caktuar, tenton të ushtrojë ndikime jo etike ndaj prokurorëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë. Veprimet e tij dhe të përfaqësuesve të tjerë të Studios Ligjore "Jurisprudenca", anëtar i së cilës ai është, janë ushtruar në formën e bashkëpunimit të hapur, që ai ka me gazetarë të emisionit investigativ "Stop" në TV Klan, ku ky avokat për interesat e tij thellësisht personale dhe aspak publike, angazhon gazetarë të këtij emisioni, me qëllim për të ndikuar dhe diktuar vendimmarrjen dhe disponimet e prokurorëve në çështjet konkrete". Ankuesi pretendonte se gjatë emisionit ishin kryer disa shkelje etike nga avokati dhe përfaqësuesit e medias.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes në shqyrtim të ankesës, Këshilli i Ankesave bazuar në nenin 51 të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i kërkoi OSHMA-së paraqitjen e pretendimeve.

OSHMA-ja në pretendimet e paraqitura nënvizoi se "referuar 5 çështjeve të ankuara, media ka kryer detyrën e saj në funksion të përmbushjes së parimit për informim të paanshëm të publikut".

Këshilli i Ankesave, nga këqyrja e materialeve audiovizive, nuk evidentoi se kishte shkelje të

ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (neni 4, pika 1), ku sanksionohen "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive" si më poshtë: a) veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë; b) veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve; c) veprimtaria e transmetimeve audiovizive nuk lejohet të cenojë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar; ç) veprimtaria e transmetimeve audiovizive siguron informim objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet, si dhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit; d) veprimtaria e transmetimeve audiovizive garanton të drejtën e çdo shtetasi për të marrë shërbime të transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, të ofruara për publikun nga operatorët e shërbimeve audiovizive, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë".

Ndaj dhe çështjet e trajtuara nga emisioni "Stop", në veçanti rasti i shtetasit të huaj, përbënte interes publik. Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive arsyetoi, se "media ka informacion të vazhdueshëm nga institucioni dhe kjo është një nga parimet ligjore të veprimtarisë së tyre. Në asnjë rast, media nuk ka penguar apo të ketë kundërshtuar dhënien e pretendimeve të palës tjetër".



Ankesa e paraqitur nga:

Disa ankues

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Syri TV

Emision

20.08.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Pranë Këshillit të Ankesave të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), si organ rregullator i veprimtarisë së mediave audiovizive, u depozituan disa ankesa për një material të transmetuar në televizionin "Syri TV" nga ora 14:30 e në vijim të datës 20.08.2021. Sipas ankuesve, materiali i transmetuar kishte përmbajtje seksuale dhe për orarin e transmetuar kishte "thyer rëndë etikën televizive".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin filmik dhe konstatoi se: Pavarësisht qëllimit edukativ që kishte materiali i transmetuar, përdorimi i fjalëve seksuale "p....", "v....", etj.; në një orar të tillë transmetimi (ora 14:30 e në vijim), që ndiqej edhe nga të miturit, ishte në shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, sipas të cilit "Ofruesi i Shërbimit Mediatik Audioviziv duhet të mos transmetojë programe pornografike pa siguruar mbrojtjen e të miturve nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror", (Detyrimet e OSHMA-ve, neni 33, pika 1 germa e) ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Transmetimi i skenave të forta erotike dhe seksuale në orare jashtë përcaktimeve të Kodit të Transmetimit, miratuar nga AMA, me vendimin nr.228, datë 11.12.2017, bie ndesh edhe me këtë të fundit (seksioni 1, "Parimet Themelore", pika 1.13): "Transmetimet audiovizive, që përmbajnë elementë të pornografisë apo të dhunës së skajshme, duhet t'u nënshtrohen rregullave të

veçanta të një sistemi kontrolli, si ai i aksesit të kushtëzuar apo programeve të kriptuara. Asnjë përmbajtje pornografike nuk duhet të transmetohet në oraret kur programet ndiqen prej fëmijëve".

Ky Kod, i cili mban në konsideratë të lartë interesin më të madh të fëmijës, nuk u lejon OSHMA-ve "të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, përveç rasteve kur sigurohet, duke zgjedhur orarin e transmetimit ose ndonjë masë tjetër teknike, që të miturit të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime (Ora kufi 22:00-06:00)".

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave i tërhoqi vëmendjen OSHMA-së për të mos përsëritur shkelje të tilla që bien ndesh me kërkesat ligjore dhe parimet e Kodit të Transmetimit, duke kërkuar që të mbahej parasysh interesi më i lartë i fëmijëve në çdo transmetim të ardhshëm.

Ankesa me
objekt
"Cënimin e
të drejtave
të fëmijëve"

Ankesa e paraqitur nga:

Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri-CRCA/ECPAT

Subjekti audioviziv

Programi

Data

TV Klan

Emisioni "Stop"

29.09.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), mori një ankesë nga Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri - CRCA/ECPAT, e cila pretendonte se në emisionin "Stop", transmetuar në televizionin "Klan" më 9 shtator 2021, kishte shkelje të Kodit të Transmetimit. Përfaqësuesit e Qendrës, pretendonin se emisioni kishte pasqyruar detaje të cilat nuk përputheshin me vlerësimet dhe dokumentacionin e çështjes së trajtuar. Sipas tyre "gazetari investigativ, pa asnjë tagër dhe ekspertizë, i cili e diagnostikon vajzën e ngacmuar dhe dhunuar, me simptoma të spektrit autik... nuk ka informuar prindërit mbi qëllimin e intervistës si edhe nuk ka respektuar etikën, duke e ekspozuar atë me zë dhe fytyrë, emrin dhe mbiemrin si edhe vendndodhjen e vajzës së dhunuar".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave e mori në shqyrtim ankesën dhe këqyri pamjet e transmetuara nga emisioni "Stop", në datën 9 shtator 2021 dhe konstatoi shkelje të dyfishtë të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar nga AMA, me vendimin nr.228, datë 11.12.2017. Pavarësisht interesit publik të dyshimit të një rasti të patrajtuar siç duhej, nga pikëpamja penale dhe legale, ligji "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodi i Transmetimit, vendosin në qendër interesin më të lartë të fëmijës, aq më tepër, në rastin konkret të një të miture, e cila dyshohej se ishte dhunuar dhe ndodhej nën rehabilitim. "veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton... personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve", (ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

tek "Parimet themelore", neni 4, pika 1, germa b). Këto parime gjenden të mirëpërcaktuara edhe në Kodin e Transmetimit, konkretisht në seksionin 1, ku OSHMA-ve u kërkohet "të respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut, si dhe të respektojnë në mënyrë të veçantë të drejtat, interesin më të lartë të fëmijës, si dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve", në seksionin 5, pika 5.1, sipas të cilës "OSHMA-ve u ndalohet çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo i deklaruar fajtor për kryerjen e një veprë penale, përveç rasteve me interes publik" dhe pika 5.4, ku sanksionohet se: "Të dhënat e publikuara për fëmijët në media duhet të shmangin: identifikimin dhe inicialet e fëmijës; identitetin e prindërve, apo të çdo të afërmi që bën të mundur identifikimin e fëmijës; rrethana, detaje mbi ngjarjen, që bëjnë të mundur identifikimin e fëmijës, cenojnë dinjitetin e tij dhe nuk i shërbejnë interesit publik; emër shkollë, kopshti, institucioni në rastet kur situata e abuzimit të verës penale nuk kanë ndodhur në institucion; emrin e autorit të krimit, i cili ka marrëdhënie gjaku me viktimën".

Nga këqyrja e materialeve audiovizive rezultoi, se përmbajtja e transmetimeve audiovizive të emisionit të datës 9 shtator 2021, identiteti i fëmijës zbulohet plotësisht duke shkelur dispozitat ligjore përkatëse.

Nisur nga sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar nga AMA, me vendimin nr.228, datë 11.12.2017.

Këshilli i Ankesave kërkoi nga OSHMA-ja dhe ndalimin e ritransmetimit të emisionit në fjalë si edhe heqjen e materialeve audiovizive nga kanali zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga:

Dhjetëra ankues

Subjekti audioviziv

Programi

Data

TV "Klan"

Seriali filmik "H.O.T"

01.11.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) iu drejtuan disa ankesa në lidhje me serialin filmik "H.O.T", të transmetuar në televizionin "Klan" në 24.10.2021.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi me kujdes pamjet filmike të serialit në fjalë dhe konstatoi skena dhe fjalor të papërshtatshëm për orarin që transmetohej ky serial. Seriali ishte transmetuar në oraret 20:12:46; 20:18:50; 20:32:00; 20:56:20 dhe skenat erotike ishin transmetuar në orën 20:38:39.

Këshilli i Ankesave vlerësoi se transmetimi i këtij seriali në orën 20:05 dhe në vijim ishte në shkelje të Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive, i cili siguron mbrojtje të veçantë të fëmijëve nga transmetimet e papërshtatshme audiovizive (seksioni 5) dhe përcakton qartë rregullat që duhet të kenë parasysh OSHMA-të në transmetimet e programeve të tyre.

OSHMA-ve u ndalohet "të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve, në veçanti filma apo programe që përmbajnë pornografi ose që paraqesin skena dhunë të skajshme dhe artificiale", (pika 5.30 e Kodit të Transmetimit).

Gjithashtu, "OSHMA-të duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik ose moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike, që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime. (Ora kufi 22.00 - 06.00)", (pika 5.34).

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave vlerësoi se seriali "H.O.T" përmbante skena dhe fjalor të papërshtatshëm si dhe dëmtonte zhvillimin mendor, fizik ose moral të fëmijëve, ndaj Këshilli i Ankesave bazuar në sa më sipër

- tërhoqi vëmendjen për shkelje të Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive;
- kërkoi ndërprerjen e transmetimit të serialit "H.O.T" në orarin e transmetuar dhe zhvendosjen e transmetimit në orarin kufi që përcakton Kodi i Transmetimit, duke e shoqëruar vazhdimisht me shenjë paralajmëruese, sipas përcaktimeve të pikës 5.48 të Kodit.

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive u kërkoi OSHMA-ve gjithashtu që në çdo transmetim të mbahej parasysh interesi më i lartë i fëmijëve.

Ankesa e paraqitur nga: **Dhjetëra ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV "Klan"	Emisioni investigativ "Stop"	08.11.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Dhjetëra ankesa iu drejtuan Autoritetit të Mediave Audiovizive për përmbajtjen e emisionit "Stop", të transmetuar në televizionin "Klan", në datën 02.11.2021, në orën 20:25. Ankuesit pretendonin se "është nxitur hapur gjuhë jo-etike dhe fjalor i papërshtatshëm". Gjithashtu, sipas ankuesve, gjatë emisionit "është nxitur hapur gjuhë urrejtje dhe dhunë ndaj komunitetit LGBT".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi i shqyrtoi me kujdes pamjet përkatëse filmike, konstatoi shkelje të dyfishtë, si të ligjit "Për mediat audiovizive" ashtu edhe Kodit të Transmetimit.

Pavarësisht se, Këshilli i Ankesave vlerësoi qëllimin sensibilizues të emisionit "Stop", në dobi të interesit publik në raportimin e këtyre dukurive, përdorimi i fjalorit erotik, të papërshtatshëm për orarin e transmetimit, ku mund të ndiqej edhe nga fëmijët, nuk përligjte shkeljen e ligjit "Për mediat audiovizive" dhe të Kodit të Transmetimit.

Te detyrimet e OSHMA-ve në transmetimet audiovizive specifikohet se "Ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv duhet të mos transmetojë programe pornografike pa siguruar mbrojtjen e të miturve nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror", (Neni 33, pika 1, germa e) e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Gjithashtu, Kodi i Transmetimit, një akt i rëndësishëm nënligjor, i miratuar me Vendimin e AMA-s nr.228, datë 11.12.2017, i ndalon transmetimet audiovizive që mund të dëmtojnë fëmijët. Duke iu referuar fjalorit të përdorur gjatë trans-

metimit të emisionit (minuta 32:10), Këshilli i Ankesave i kujtoi OSHMA-së, pikën 5.34 të Kodit të Transmetimit i cili përcakton qartësisht se: "OSHMA-të duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike, që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime" (ora kufi 22:00-06:00).

Gjithashtu edhe sipas pikës 5.44 të Kodit të Transmetimit: "Për programet që transmetohen në fashën orare 19:00-22:00, bëhet i detyrueshëm përdorimi i shenjave paralajmëruese për programet që cenojnë e dëmtojnë fëmijët".

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s:

- tërhoqi vëmendjen për të mos përsëritur rastet që bien ndesh me kërkesat ligjore dhe parimet e Kodit të Transmetimit, si dhe rikujtoi zbatimin e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit për materialet filmike të ngjashme (që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve), duke kërkuar transmetimin e tyre në orarin kufi që përcakton Kodi i Transmetimit.
- kërkoj heqjen dhe korrektimin e materialit përkatës filmik nga kanali zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga: **Disa ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV "Top Channel"	Emisioni "Shqipëria live"	11.08.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Pranë Këshillit të Ankesave mbërritën disa ankesa në lidhje me emisionin "Shqipëria live", të transmetuar në televizionin "Top Channel" në 04.01.2021. Ankuesit pretendonin se ishin shkelur të drejtat dhe privatësia e fëmijëve, gjatë transmetimit të intervistës së të miturit 14-vjeçar, i cili fliste nga banesa dhe nga vendi i krimit lidhur me vrasjen e nënës së tij.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s pasi shqyrtoi me kujdes materialin filmik, konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit. Konkretisht, intervistimi i të miturit në zbulim të plotë të identitetit të tij, i cili tregonte detaje nga vendngjarja, për vrasjen në të cilën kishte qenë dëshmitar, cenonte rëndë interesin e të miturit. Në këto kushte nuk duhej transmetuar intervista, duke rrezikuar zhvillimin moral dhe fizik të tij.

Në nenin 4 të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku sanksionohen "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive" përcaktohet se: "Transmetimet audiovizive zhvillohen mbi bazën e këtyre parime: në pikën b) sanksionohet se "veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve".

Referuar rastit në fjalë, Kodi i Transmetimit, sanksionon, se "OSHMA-ve u ndalohet raportimi apo transmetimi, që çon direkt apo indirekt në

identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar apo i deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale, përveç rasteve me interes publik" (Seksioni 5, pika1) si edhe se "Duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare. Ndalohet intervistimi i fëmijës që mund të jetë përfshirë në një ngjarje të rëndë; p.sh, fëmijë të larguar nga familja, që kanë tentuar të vrasin veten, që janë përdorur nga grupe kriminale, që kanë qenë brenda një rrjeti prostitucioni, që i kanë prindërit të dënuar" (Seksioni 5, pika2).

Këshilli i Ankesave konstatoi, se intervistimi i të miturit në kushtet kur ai rrëfen ngjarjen e rëndë kriminale nga vendi i ngjarjes, përbënte shkelje të rëndë të Kodit të Transmetimit ndaj dhe nuk duhej të transmetohej. Transmetimi i tij, veç pasojave të tjera, mund të sjellë dëme serioze për shëndetin e të miturit në kushtet kur transmetimet audiovizive duhen të kenë bazë interesin më të lartë të fëmijëve.

Bazuar në sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive i tërhoqi vëmendjen OSHMA-së, duke kërkuar ndalimin e çdo transmetimi të kësaj interviste, respektimin e ligjit "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Transmetimit në përmbajtjet e ardhshme audiovizive si dhe mbajtjen parasysh të interesit më të lartë të fëmijëve dhe interesit publik.

Më tej, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s paralajmëroi se përsëritja e shkeljeve të ngjashme do të përcillej me propozim për sanksione financiare në Bordin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, sipas parashikimeve ligjore përkatëse.

3

Ankesa me
objekt
"Komunikime
tregtare të
ndaluar"

Ankesa e paraqitur nga:

E.S

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Report TV**Emisioni "Reze Dielli"****18.10.2021**

1. Përmbledhje e Ankesës

Shtetasja E.S i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave nisur nga deklaratimet e një pacienteje në emisionin "Reze Dielli", të transmetuar në televizionin Report TV më datë 18.10.2021. Sipas ankueses, "një paciente e diagnostikuar me tumor, ka dhënë këshilla që mund të konsiderohen të papërshtatshme dhe të rrezikshme se si mund të "shërohesh", duke reklamuar produkte të mjekësisë bimore, të përgatitura nga specialisti i bimëve mjekësore, Ylli Merja".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s shqyrtoi materialin filmik dhe konstatoi shkelje të dyfishtë të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit.

Më konkretisht, reklamimi i produkteve të mjekësisë bimore nga moderatorja e emisionit u identifikuan si komunikim tregtar i fshehur, cili referuar ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, komunikime ndalohet si më poshtë: "Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive duhet të jenë qartësisht të dallueshme si të tilla. Komunikimet me natyrë tregtare të fshehura janë të ndaluara", (neni 42, pika 1 e ligjit nr.97/2013)

Reklamimi i këtyre produkteve të mjekësisë bimore përbën shkelje edhe të neneve 42, pika 2 e ligjit "Për mediat audiovizive", ku sanksionohet, se: "Komunikimet me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive nuk lejohet të përdorin mënyra të joshjes së shikuesve në mënyrë të pandërgjegjshme dhe teknika për sugjestionimin e tyre".

Bazuar në përcaktimet e mësipërme të ligjit, Këshilli i Ankesave në vendimarrjen e tij ar-

syetoi, se vendosja e produkteve në programe, si një mënyrë e fshehur dhe abuzive e komunikimit me natyrë tregtare ndalohet, përveçse në filma, vepra kinematografike, seriale të prodhuara për shërbimet e transmetimit mediatik, programeve sportive dhe atyre zbatimëse. "Programet që përmbajnë vendosjen e mallrave nuk duhet të nxisin drejtpërdrejt marrjen ose përdorimin e mallrave dhe shërbimeve, veçanërisht duke bërë përmendje të posaçme promovionale të këtyre mallrave dhe shërbimeve si dhe nuk duhet t'i kushtojnë vëmendje të tepruar mallrave në fjalë", (Neni 44, pika 3/b dhe c e ligjit për mediat audiovizive).

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s çmoi se tema të tilla të ndjeshme, specifike dhe me interes duhen diskutuar me ekspertë të mjekësisë, të cilët të flasin me kompetencë, profesionalizëm dhe realizëm dhe vlerësoi se deklaratat e cituara nga pacientja e intervistuar me tumor që "shërohet" nëpërmjet produkteve të mjekësisë bimore, ishin shqetësuese, të dëmshme për shëndetin publik dhe në shkelje të normave ligjore dhe parimeve etike.

Ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 33, pika b, përcakton detyrimet e çdo OSHMA-je, që "të sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në këto çështje dhe që paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme".

Në këtë frymë edhe Kodi i Transmetimit, i miratuar me Vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, (seksioni 3, pika 5) kërkon "Mbrojtjen e shëndetit publik dhe të sigurisë".

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë AMAs tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit.



Ankesa e paraqitur nga: **Shoqëria "HAKO" sh.p.k**

Subjekti audioviziv

RTV "Ora News"

Programi

Edicione informative

Data

01.11.2021

1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s mori një ankesë nga përfaqësues të shoqërisë "HAKO" sh.p.k e cila pretendonte se me datë 25.10.2021 në televizionin "Ora News" ishte transmetuar një lajm i pavërtetë nga gazetarja A.Ç. Përfaqësues të shoqërisë tregtare pretendonin se "në edicionet informative ishte publikuar një lajm shpifës dhe denigrues duke cenuar vërtetësinë e lajmit dhe integritetin e shoqërisë".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin filmik dhe konstatoi se kronika e transmetuar pasqyronte një lajm mbi asgjësimin e disa produkteve të skaduar të kësaj kompanie, bazuar mbi dokumentacionin zyrtar të Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

Referuar nenit 51 të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i Ankesave i kërkoi OSHMA-së paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e sipërcituar.

Në përgjigjen dërguar Këshillit të Ankesave, Bordi i Shqyrtimit të Ankesave të OSHMA-së sqaroi, se kronika e transmetuar në edicionin informativ të datës 25.10.2021 i referohej burimeve zyrtare, të përcjella në formë shkresore, konkretisht materialit zyrtar të lëshuar nga Agjencia Rajonale e Mjedisit.

Referuar materialeve të mësipërme, Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Repub-

likën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe as të Kodit të Transmetimit.

Në vendimmarrjen tij, Këshilli i Ankesave arsyetoi, se media audiovizive kishte transmetuar një lajm të bazuar në dokumente zyrtare, duke respektuar parimin më të rëndësishëm të medias, atë të lirisë së shprehjes dhe informimit të publikut, siç përcaktohet edhe në nenin 4, pika 1 e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ankesa me
objekt
të ndryshëm

5

Ankesa të
rrethuar

Ankesa e paraqitur nga: **Sh.K**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV "Top Channel"	Emisioni "Fiks Fare"	28.09.2020

1. Përmbledhje e Ankesës

Shtetasi Sh. K. i është drejtuar Këshillit të Ankesave lidhur me emisionin "Fiks Fare", transmetuar në televizionin "Top Channel", më datë 28.09.2020. Ankuesi pretendonte, se emisioni në fjalë kishte trajtuar në mënyrë të njëanshme një çështje pronësie, duke i cenuar imazhin dhe dinjitetin.

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi mori në shqyrtim ankesën në lidhje me një lajm të transmetuar në emisionin "Fiks Fare", më datë 28.09.2020, duke iu referuar kuadrit ligjor, evidentoi se ankesa ishte jashtë afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, pasi "ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë" (referuar ligjit nr.97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52, "Shqyrtimi i ankesave").

Ankesa e paraqitur nga: **D.F**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
RTV "Ora News"	Emisioni "Boom"	26-27.06.2019

1. Përmbledhje e Ankesës

Shtetasi D.F i nisi një ankesë Këshillit të Ankesave në lidhje me emisionin "Boom", transmetuar në televizionin "Ora News" në datat 26-27 Qershor 2019. Ankuesi pretendonte se ishte dhënë "një lajm i rremë" dhe se e njëjta përmbajtje gjendej edhe në kanalën e saj zyrtar në "Youtube".

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit, Këshilli i Ankesave i bëri me dije ankuesit se ankesa ishte jashtë afateve ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Bazuar në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 52, "Shqyrtimi i ankesave", sanksionohet se "Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë".

Referuar ankesës, ku thuhej se e njëjta përmbajtje gjendej edhe në "Youtube", Këshilli i Ankesave informoi se "publikimi në mediat online është jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive". Referuar Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionohet se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Fund

**AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II",
Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë.
www.ama.gov.al

këtej, mbështetur në Kodin
të miratuar nga A
e Audiovizive i cili përm
parimet, rregullat, kërkes
e transmetimeve audioviz
ën e Shqipërisë, Këshilli i
n të vëzhgojë me kujdes se
të mirëpërcaktuara për p
etimet audiovizive zbatoh
i Këshillit të Ankesave i
kohësh ka qenë i mundur
audioviziv si këshillues i pë
meve audiovizive, është n
të cilin raportohen resul
vara nëpërmjet të cilave dy
arimet, rregullat, kërkesat